

1444 DITË

TË

QEVERISË "RAMA 2"

2017 - 2021

...në analizën tonë

1444 DITË TË QEVERISË“RAMA 2”

2017 - 2021

...në analizën tonë

QENDRA ALTAX

Analizë

GUSHT 2021

ALTAX

Dokumente Politike e Fiskale

Nr.2021/08/06

www.altax.al

Datë 25.08.2021

Tiranë, Shqipëri

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e kësaj analize mund të përdoret lirisht prej përdoruesve, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e “Qendrës AL-TAX” si burim informacioni.

ALTAX

POLIFAKT_{al}

PËRMBLEDHJE

Votuesit kanë një kuptim të gjerë dhe e kanë të pamundur të identifikojnë me saktësi realizimin e programeve qeverisëse. Performanca e programit politik duket se në rastin e qeverisë "Rama 2" nuk ka arritur të jetë më shumë se një nivel prej 52% në rastin më të mirë, kur disa nga programet janë konsideruar si të realizuara edhe pse ende nuk rezultojnë që të jetë plotësisht ky realitet.

Në rastin, kur qeverisja është drejtuar nga vetëm një parti politike, ajo mbetet përgjegjëse në përputhje me konsekuencën e politikave të zbatuara edhe nga qeverisja më parë në fusha të ndryshme të jetës së vendit. Me këtë qasje, ajo mundet të ndikojë orientimin e votës edhe për votuesit e pavendosur, por edhe ata klientelistë duke e konsideruar se është më afër preferencave të tyre.

Strategjia elektorale që ka përdorur me sukses Partia socialiste edhe në këto kushte ka funksionuar si një largpamësi për të kënaqur pritshmëritë e votuesve për të ardhmen duke përdorur performancën e kaluar të qeverive të mëparshme si një bazë krahasimi në rastin më të mirë, por edhe si një justifikim për mosrealizimet në rastin më të keq.

Në qeverisjen 2017-2021, për herë të parë pas 3 dekadash histori politike, pas përmbyesjes së rendit politik të kaluar formohet një qeveri e përbërë me anëtarë vetëm nga PS. Nga analiza e programit të qeverisë dhe realizimit të tij, konstatohet se *niveli i përmbushjes* nga qeveria "Rama 2" i premtimeve të dhëna në fushatë zgjedhore rezultojnë një nivel prej 52 përqind me një rritje të nivelit krahasuar me qeverisjen paraardhëse me 16 përqind.

Sektorët që kanë një realizim më të madh janë arsimiti, bujqësia, politikat sociale dhe politikat fiskale.

Mospërmbushjen më të madhe e gjejmë në gjithë sektorët për rritje shpenzimesh buxhetore, për politikat e rinisë, si dhe politikat e rritjes së pensioneve.

Në një shikim të sektorëve më gjithpërfshirës për jetën e vendit shikojmë se programi kryesisht ka mbetur i parealizuar në një nivel që tejkalon mbi 65% të këtyre sektorëve specifikë si më poshtë.

Përmbushja e *programit për punësimin* nuk ka arritur të kalojë nivelin e 40%. Një ndikim në këto të dhëna vjen nga efekti i pandemisë Covid-19, e cila për vitin 2020 ka stopuar

punësimet sipas ritmeve të parashikuara. Por, edhe sikur të marrim në analizë vetëm dy vitet normale (2018 – 2019) të qeverisjes “Rama 2”, vërehet se ritmi i rritjes së punësimeve nuk mund të kalojë më shumë se niveli i përmbushjes së premtimit të 100 mijë punonjës në 4 vite. Kjo llogaritje vjen si rrjedhojë e *treguesit të zhvillimit ekonomik*, që nuk u rrit sipas premtimeve të dhëna, por edhe te niveli i njëjtë i investimeve të huaja nëse krahasohen me qeverisjen e kaluar. Nga të dhënat e cituara në tabelat analitike të kësaj analize, rezulton se investimet e huaja për 4 vitet e qeverisjes nuk do të kalojnë përtej 3.9 miliard Euro. Këto investime llogaritet të kenë dhënë një efekt pozitiv në ekonomi me të paktën 7.5 miliard lekë, duke patur parasysh sektorët ku është investuar dhe efektin zinxhir në të ardhurat tatimore.

Programi për *mbrojtjen dhe përkujdesjen sociale* nuk ka zënë vend më të madh se në qeverinë e kaluar në programet e qeverisë 2017 - 2021. Nga matja e alokimeve buxhetore të realizuara ato i kanë kushtuar buxhetit 4 vjeçar 29% përqind të kostos buxhetore së premtuar. Në këtë kategori premtimesh përfshihen edhe premtimet për pensionet, të cilat nuk arritën të përmbusheshin edhe pse ky premtim nuk është përmbushur asnjëherë nga qeveritë shqiptare pas viteve ‘90. Në një krahasim të dy premtimeve të vitit 2017 për pensionet: (a) Paketa e solidaritetit për pensionistët 24 miliard lekë dhe (b) Rritje vjetore pensionesh dhe shpërblim fundviti nga 7-10 mijë lek, nga verifikimi i të dhënave të buxheteve 2017-2021 (ky i fundit është në zbatim) nuk rezulton përmbushja në nivelet e premtuara.

Programi për bujqësinë, si një sektor që vijon të adresohen shumë premtime dhe në fushata zgjedhore, vërehet se nuk është alokuar më shumë se 35 miliardë lekë shtesë, që arrin deri në 19% të shumës së premtuar.

Programi për arsimin zë një vend nga më kryesorët në programin qeverisës dhe vijon si pjesë e konsistencës së programit të qeverisë “Rama 1”, 2013 - 2017. Kur krahasojmë vlerën e premtuar të buxhetit të llogaritur në 18.5 miliard lekë, rezulton se alokimet shtesë faktike që janë bërë në 4 vite e tejkalojnë këtë kosto të vlerës së premtimeve me 32 përqind. Alokimet shtesë kanë kaluar në pjesë të madhe për rritjen e numrit të shkollave të arsimit parauniversitar duke qenë një nga sektorët që premtimet janë përmbushur në masë më të madhe se sektorët e tjerë

Për infrastrukturën rrugore, për mjedisin dhe turizmin Qeveria “Rama 2” shpalli paketën “1 miliard”. Ndërkohë, programi qeverisës vijon të mbulojë pjesën e shpenzimeve që janë paguar nga buxheti në vite rutinore duke e kaluar pjesëm më të madhe të kostos së infrastrukturës rrugore te sektori privat që ka nënshkruar marrëveshje partnershipi me qeverinë. Natyrisht, që kjo kosto do të mbulojë hapësira fiskale në 10-15 vitet në vijim duke mos lënë shumë për të planifikuar nga qeverisjet që do të vijnë. Megjithatë edhe pse

nuk ka premtime me emertime në fakt vlera e premtimeve të përgjithshme, sipas analizës që ne i bëmë rezulton në 65 miliard lekë. Në fakt aktualisht buxheti ka alokuar burime shtesë në vlerën 78 miliard lekë, por këtu përfshihen edhe kostot e inceneratorëve. Nisur nga paqartësitë dhe të dhëna të paplota ne nuk mundemi të bëjmë dot një krahasim të detajuar për nënkomponentët që përbëjnë infrastrukturën, por shprehemi edhe pse me rezerva, se vlerat e premtuar janë përmbushur me alokimet shtesë buxhetore.

Kur analizojmë programin për ujësjellësa dhe rrjetin e kanalizimeve llogaritjet zënë një vlerë jo të vogël (15 miliard lekë). Në fakt, nga krahasimi me fondet e alokimeve të buxhetit për këtë sektor shikohet se është përmbushur vlera e premtuar në nivelin e 80 përqind.

Politika fiskale e premtuar në analizën që ne bëmë është kufizuar në të paktën dy vite fiskalë, 2018 dhe 2019 duke marrë në konsideratë situatën e jashtëzakonshme të ndikuar prej bllokimit të ekonomisë nga pandemia. Për periudhën e analizuar rezulton se politikat e zbatuara sipas premtimeve të vitit 2017 kanë dhënë një efekt shtesë në të ardhurat e buxhetit me 6.9 miliard lekë. Ky kontribut, është ndikuar nga rritja e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale me 9.6 miliard lekë. Në këtë rritje të lartë ka ndikuar efekti i uljes së tatimit mbi dividendin, i cili ka favorizuar pagesat nga kompanitë e mëdha që janë rezidente në Shqipëri në kontribut vjetor prej 7.8 miliard lekë.¹ Kjo rritje e të hyrave nga ky tatim ka mbuluar deficitet edhe për TVSH dhe tatim fitimin. Gjithashtu edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore kanë dhënë një vlerë të shtuar në buxhet me 5.3 miliard lekë.

Nëse analizojmë tatimin mbi të ardhurat personale pas më shumë se 6 vitesh nga fillimi i zbatimit të mekanizmit fiskal të taksimit progresiv shikojmë se kontributi në buxhet është 16.5 miliard lekë, ku 8 miliard lekë është kontributi vetëm nga tatimi mbi pagat. Nisur nga ky fakt buxhetor, progresiviteti është bazuar dhe rënduar mbi pagat e punonjësve, ku më i rënduari është pjesa e pagave të larta nga sektori privat. Natyrshëm, që ky kontribut është i rëndësishëm për të hyrat e buxhetit, por momenti që një taksë rëndon mbi një kategori apo segment taksapaguesish dhe nuk takson gjithë kategoritë e tjera duhet të rishikohet për një shpërndarje të re dhe të drejtë të barrës fiskale.

Në tërësinë e saj, një nivel realizimi në vetëm 52% e programit meriton një analizë me thellë dhe autokritike nga ana e qeverisë, për të adresuar në detaje përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë konkrete.

Reformat kryesore të shpallura si boshte kryesore, të tilla si: reforma e ujit, reforma e tokës, reforma e drejtësisë, reforma e energjisë, reforma e pensioneve etj. Duket se kanë

¹ <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=7511>

probleme me ecurinë e tyre. Në rastin më të mirë ato kanë stopuar dhe nuk po ecin sipas planifikimit (reforma e energjisë, reforma e tokës, reforma e pensioneve). Në rastin më të keq ato ende nuk kanë filluar apo janë në stade përgatitore (reforma e ujit).

Edhe pse shikohet se ka referim të Programit qeverisës të Strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale (mbi 15 dokumente strategjike), të Programet Kombëtare, të Programet Buxhetore Afatmesme, të Kuadri Makroekonomik Fiskale, si dhe të dokumente kombëtare, që kanë afat veprimi përtej mandatit të një qeverisje, gjithsesi konstatohet se ato gjejnë një nivel realizimi të vogël krahasuar me faktet e qeverisjes, që përkon me nivelin e realizimit të programeve dhe poshtë këtij niveli për strategji të caktuara (p.sh. Strategjia Kombëtar e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030).

Mungesa e koherencës në këto dokumente vizionare për qeverisje, ka diktuar qasje të reja më të vështira, pasi shikojmë që qeverisja pothuajse nis politika mjaft optimiste pa u thelluar te realiteti faktik i performancës së menaxhimit të sektorit.

Për strategjitë më të rëndësishme të vendit nuk mund të ketë njëanshmëri dhe ekskluzivitet vetëm qeveria që i miraton ato, por nevojitet një qasje që mundet të bashkojë politikën e polarizuar të dokumentet strategjike, veçanërisht për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe rëndësinë e tyre.

E gjithë kjo qasje do të japë mundësinë e një stafete midis partive dhe jo një "fillimi" të ri për çdo mandat të ri qeverisje duke ndërtuar strategjitë e reja mbi rrënojat e atyre egzistuese.

Në analizën e sektorëve më të rëndësishëm dhe që përfshijnë një pjesë të madhe të ekonomisë dhe punonjësve, përfshirë financat publike shikohet se realizmi nuk është arritur. Përtej qasjeve optimiste dhe që nuk reflektojnë realitetin e stadi të zhvillimit të vendit në secilin sektor duhet që të analizohet në vijimësi pengesat, mungesat dhe nevojat për të qenë në kohezion me programin e ri 2030.

Në vijim është programi qeverisës 2017 -2021, i detajuar dhe analiza² e realizimit të tij zë për zë.

² Në analizën e treguesve makroekonomikë (PBB, rritja ekonomike, punësimi) janë marrë në shqyrtim periudha 2017-2019, si dhe ecuria e tyre në 6-mujorin e parë 2021, pa harruar që viti 2020 ishte viti që frenoi dhe madje reflektoi rënie të tyre. Ndërsa, për analizën e projekteve dhe programeve sektoriale dhe ato buxhetore, përfshirë edhe performancën fiskale janë marrë në analizë raportet e PBA dhe analizat buxhetore për të njëjtat periudha, por edhe tendenca e tyre (borxhi publik, investimet, ecuria e të ardhurave, informaliteti, etj.).

Programi qeverisës 2017-2021³

Gjatë mandatit 2017-2021, Qeveria do të angazhohet me prioritet në konsolidimin e stabilitetit makroekonomik, rritjen e punësimit, zhvillimin e infrastrukturës, sektorit energjetik e minerar, bujqësisë, agroindustrialisë dhe turizmit.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet politikave ekonomike e financiare që stimulojnë investimet në drejtim të rritjes dhe të zgjerimit të industrializimit nëpërmjet shtimit të aktiviteteve me karakter industrial. Kjo do të synojë rritjen e kapaciteteve prodhuese e përpunuese të sektorit industrial në Shqipëri.

Ekonomia

Përmes zbatimit të plotë të këtij programi ne synojmë një rritje ekonomike mesatare rreth 4.5 përqind për të arritur në rreth 5.5 - 6 përqind të PBB-së në fund të mandatit (**E PAREALIZUAR**)⁴.

Qeveria Shqiptare angazhohet për uljen graduale të borxhit publik në rreth 60% të PBB-së deri në fund të mandatit (**E PAREALIZUAR**)⁵.

Investimet publike të financuara nga buxheti i shtetit do të jenë rreth 5% e PBB-së (**PJESËRISHT E REALIZUAR**)⁶.

Me paketën “1 Miliard” do të injektojmë më shumë se 100 miliardë lekë në ekonomi, nëpërmjet angazhimit të kapitaleve private në një numër të madh projektsh investuese, duke ndikuar direkt në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e sektorëve prioritarë (**PJESËRISHT E REALIZUAR**).

Politike fiskale

Politika fiskale e katër viteve të ardhshme do të orientohet drejt qëndrueshmërisë dhe nxitjes së sektorëve prioritarë. Progresiviteti do të vazhdojë të jetë në qendër të filozofisë sonë fiskale.

Ne do të vazhdojmë përkrahjen e sipërmarrjes me masa fiskale, përveç lehtësive procedurale që tashmë janë aplikuar.

³ <https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf>

⁴ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Economic-Reform-Programme-2021-2023.pdf>

⁵ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/Buletini-i-Borxhit-Q4-2020-versioni-shqip.pdf>

⁶ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/Kuadri-Makroekonomik-e-Fiskal-p%C3%ABr-periodh%C3%ABn-2022-2024-VKM-Nr.-7-dt-13.1.2021-.pdf>

Gjatë mandatit të dytë synohet që:

- Tatimi mbi të ardhurat personale për fashën e lartë të të ardhurave nga paga të ulet në 18% (E PAREALIZUAR).
- Tatimi mbi dividendin të reduktohet në 6% (E REALIZUAR).
- Tatim-Fitimi për prodhimin në Teknologjinë e Informacionit për të nxitur zhvillime në një industri të domosdoshme për zhvillimin ekonomik afatgjatë të shkojë në 5% (E REALIZUAR).
- T'iu jepet ndihmë familjeve të reja për blerjen e shtëpisë së parë, duke njohur si shpenzime të zbritshme interesat e kredive të marra për këtë qëllim (E PAREALIZUAR).

Pas rritjes së të ardhurave buxhetore me rreth 3.7% të PBB-së gjatë mandatit 2013-2017, angazhimi i Qeverisë për mandatin 2017-2021 është sigurimi i të ardhurave në nivelin 28% të PBB-së (E PAREALIZUAR).

Ky synim mbështetet në zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, ku kontribut kryesor do të kenë rritja ekonomike, lufta kundër informalitetit, zhvillimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit të administratave fiskale për të rritur efikasitetin e punës, zhvillimi i mëtejshëm i kuadrit legjislativ fiskal, si dhe forcimi i burimeve njerëzore të administratës (E PAREALIZUAR)⁷.

Energjia

Politika e Qeverisë në këtë mandat të ri do të vazhdojë të orientohet drejt rritjes të sigurisë së furnizimit me energji të konsumatorëve, duke pasur për objekt mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet rritjes së punësimit dhe promovimit të energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë, duke stimuluar konkurrencën në treg, duke siguruar stabilitet dhe minimizuar kostot për konsumatorët shqiptarë, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit (E PAREALIZUAR).

Në sektorin elektroenergjetik

Drejtime kryesore:

⁷ <https://altax.al/al/publikime-te-altax/product/boshlleku-i-tvsh-se-ne-shqiperi-dhe-kosove-2021>

- (a) rritje të kapaciteteve gjeneruese (PJESËRISHT E REALIZUAR);
- (b) diversifikim të burimeve gjeneruese (E PAREALIZUAR);

- (c) rritje të kapaciteteve transmetuese ndërkufitare dhe brenda vendit për të garantuar furnizim të vazhdueshëm të vendit me energji, stabilitet dhe cilësi në furnizim (PJESËRISHT E REALIZUAR);

- (d) vazhdimin e procesit të ndarjes së OSHEE sipas ligjit të sektorit të energjisë elektrike, ulje të vazhdueshme të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, garantimin e aksesit për burimet e reja dhe zhvillimin e tyre (PJESËRISHT E REALIZUAR);

- (e) krijimin e bursës së energjisë dhe krijimin e tregut të organizuar të energjisë (PJESËRISHT E REALIZUAR);

- (f) integrimin e tregut me tregun e Kosovës dhe atë rajonal (E PAREALIZUAR);

- (g) përafrimin e plotë të të gjithë legjislacionit të sektorit me atë evropian (PJESËRISHT E REALIZUAR);

- (h) stimulim të investimeve ;

- (i) vazhdim të betejës pa kompromis me korrupsionin dhe vjedhjen e energjisë elektrike.

Gjenerimi synon kryerjen e 22.6 miliardë lekë investime për forcim të kapaciteteve gjeneruese të sektorit publik (E PAREALIZUAR)⁸.

Transmetimi i energjisë elektrike do të realizojë një total investimesh prej rreth 21.3 miliardë lekë. Në pikëpamjen strategjike janë projekti për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni) dhe Elbasan2 – Fier, si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan2 dhe Fier (E PAREALIZUAR)⁹.

Shpërndarja dhe furnizimi pritet të realizohet një total investimesh prej rreth 70 miliardë lekë (rreth 50 miliardë lekë investime nga buxheti publik në rrjetin e shpërndarjes dhe 5.3 miliardë lekë të Bankës Botërore, 6.6 miliardë lekë me financim të KfW për sistemin Skada dhe rreth 6.6 miliardë lekë investim për leximin e matësve *smart*) për periudhën 2017-2021 (E PAREALIZUAR)¹⁰.

⁸ <https://www.ere.gov.al/sq/publikime/vendimet/2021/viti-2021>

⁹ <https://www.ere.gov.al/sq/publikime/vendimet/2021/viti-2021>

¹⁰ <https://www.ere.gov.al/sq/publikime/vendimet/2021/viti-2021>

Në sektorin e energjive të rinovueshme, investimet e pritshme në ngritjen e impianteve të gjenerimit të energjisë nga burimet diellore janë rreth 20 miliardë lekë, ku deri në 2020-ën do të instalohen rreth 50 MW me tarifë të rregulluar dhe nga burimet me energjinë e erës, investimet e pritshme do të jenë afërsisht rreth 8 miliardë lekë, ku deri në vitin 2020 do të instalohen 30 MW me tarifë të rregulluar (E PAREALIZUAR)¹¹.

Një pritshmëri për investime të ardhshme private me rreth 53.2 miliardë lekë, me një kapacitet rreth 300 MW të instaluar (E PAREALIZUAR)¹².

Objektivi për eficienten e energjisë është reduktimi me 6.8% i konsumit të energjisë dhe të ardhurat e pritshme për ekonominë kombëtare nga kursimi i energjisë do të jenë rreth 14.6 miliardë lekë (E PAREALIZUAR)¹³.

Nafta dhe gazi

Në operimin e kërkim–prodhimit të naftës do të synohet që:

(a) gjithë vendburimet naftëmbajtëse në tokë dhe det të jenë objekt i kontraktimit nga investitorë seriozë (E PAREALIZUAR);

(b) të kemi një portofol investimesh 4-vjeçar deri në 110 miliardë lekë¹⁴ (PJESËRISHT E REALIZUAR);

(c) të promovohet tek operatorët modeli i ri ekonomik i kontratave (E REALIZUAR);

(d) të rriten kapacitetet transportuese (PJESËRISHT E REALIZUAR);

(e) të ristrukturohet kompania publike AlbPetrol sh.a. duke ruajtur një njësi teknike dhe privatizuar asetet e tjera (E PAREALIZUAR);

(f) të forcohet roli rregullator i AKBN (PJESËRISHT E REALIZUAR);

(h) të garantohet depozitimi sipas standardeve për hidrokarburet (PJESËRISHT E REALIZUAR);

¹¹ <https://www.ere.gov.al/sq/publikime/vendimet/2021/viti-2021>

¹² <https://www.ere.gov.al/sq/publikime/vendimet/2021/viti-2021>

¹³ <https://ere.gov.al/doc/Raporti%20vjetor%202020.pdf>

¹⁴ <http://ndiqparate.al/2021/07/01/origjina-dhe-stoku-i-investimeve-te-huaja-direkte-mars-2021/>

(i) të rriten kapacitetet prodhuese e tregtuese të produkteve të biokarburanteve (PJESËRISHT E REALIZUAR);

Në përpunimin e naftës do të synohet të përpunohet e gjithë sasia që prodhohet dhe destinohet në tregun shqiptar.

Në operimin e gazit natyror të prodhuar në vend synohet:

(a) të forcohen kapacitetet tregtuese dhe teknike (PJESËRISHT E REALIZUAR);

(b) të fuqizohet operatori publik AlbGaz sh.a (PJESËRISHT E REALIZUAR);

(c) të promovohet diversifikimi përmes gazit natyror (E PAREALIZUAR);

(d) të zhvillohen projektet e gazsjellësit Adriatiko-Jonian (IAP), gazsjellësit Shqipëri-Kosovë (E PAREALIZUAR).

Ne miniera

Qeveria do të angazhohet për shtimin e investimeve private në kërkim-prodhimin e mineralit të kromit dhe atë të bakrit.

Qeveria do të mbështesë edhe më tej zhvillimin e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese në industrinë minerare, duke synuar rritjen e eksporteve të produkteve të përpunuara metalore e jometalore (E PAREALIZUAR).

Përveç rritjes së punësimit dhe mirëqenies për banorët e zonave mineralmbajtëse, ky zhvillim do t'i japë një hov ekonomisë kombëtare në tërësi dhe përmirësojë bilancin tregtar të vendit (E PAREALIZUAR).

Do të nxitet ringjallja e industrisë së hekur-nikelit, duke kaluar nga fazat e zbulimit drejt asaj të shfrytëzimit (E PAREALIZUAR).

Përmes stimulimeve fiskale do të mund të zgjerohet industria përpunuese e mineraleve të prodhuara në vend (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Krijimi i fabrikave dhe impianteve të reja të pasurimit dhe përpunimit do të synojnë ciklin e mbyllur në mineralet e kromit, ferrokromit dhe bakrit (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Bujqësia

Në katër vitet e ardhshme do të financohen në zonat rurale rreth 25.5 miliardë lekë në mbështetjen e sektorit bujqësor, në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonat rurale, mbështetjen e fermerëve dhe rritjen e aksesit në tregje (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Rritja e produktivitetit në fermat e mëdha do të vazhdojë të mbështetet me më shumë se 7.8 miliardë lekë të siguruara nga programi IPARD (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Pas dyfishimit të sipërfaqes së tokës bujqësore nën sistemin e vaditjes gjatë mandatit të parë, ne do të vazhdojmë investimet me synimin 'ujë në çdo parcelë' si dhe përmirësimin e kullimit përmes thellimit të decentralizimit dhe rritjes së investimeve në sektor (E PAREALIZUAR).

Madhësia mesatare e fermës në Shqipëri është ende e vogël dhe e fragmentarizuar. Një pjesë e posaçme e ndihmës në bujqësi do të përdoret për të inkurajuar konsolidimin dhe krijimin e fermave të mëdha, me qëllim rritjen e produktivitetit, uljen e kostos së prodhimit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore (E PAREALIZUAR).

Procesi i konsolidimit të pronës në tokat bujqësore, i cili filloi në mandatin e parë qeverisës do të përmbyllet në këtë mandat, duke ulur pasigurinë mbi pronën në zonat rurale. Reforma e pronës do të krijojë terrenin institucional që të gjithë tokat bujqësore të pajisen me certifikata pronësie; do të përmirësohen strukturat bujqësore edhe nëpërmjet lehtësimit të problemit të tokave djerrë (8% e tokës bujqësore), duke zbatuar instrumente fiskale nxitëse (E PAREALIZUAR).

Ngritja e sistemit transparent të ndihmës direkte dhe këshillimit në një sportel të vetëm, do të garantojë një shërbim të specializuar, në përputhje me karakteristikat e fermave (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Zhvillimi i Treguesve Gjeografikë të Origjinës (TGJO) është alternativa që do të nxitet për katër vitet në vazhdim për krijimin e një shporte produktesh TGJO-sh shqiptare (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Do të vazhdojë kreditimi me kushte lehtësuese i agrobiznesit me 12.6 miliardë lekë (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës brenda Zonave të Përcaktuara për Akuakulturën (ZPA), do të rritet me 70 % (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Turizmi dhe mjedisi

Shqipëria do të krijojë brandin e vet dhe do ta bëjë atë sa më unik. Ky brand do të promovohet me inteligjencë dhe me mjete inovative; me spote të reja vjetore që do të nxisin kureshtjen për zbulim të destinacioneve të panjohura (E PAREALIZUAR).

Do të konsolidohen 4 destinacione turistike kombëtare; Alpet Shqiptare, Jugu i Ri, Portet e Marinat, Tirana (E PAREALIZUAR);

- Alpet Shqiptare - Një destinacion i bazuar në ecjen në mal (trekking), kjo e lidhur me natyrën, aktivitetin dhe turizmin sportiv (PJESËRISHT E REALIZUAR).
- Plazhet e Jugut dhe kombinimi me malet. Aeroporti i ri në jug do të sjellë një përmirësim të rëndësishëm (E PAREALIZUAR).
- Marinat dhe portet kanë një potencial të lartë për thithjen e turistëve të huaj dhe megjithëse në Shqipëri është rritur hyrja nga deti janë mundësitë të zhvillohen edhe 6 pika të reja portuale me shkallë të lartë shfrytëzimi (E PAREALIZUAR).
- Tirana do të vazhdojë të përmirësohet në infrastrukturë për ta kthyer atë në një qendër atraktive për evente të biznesit rajonal dhe vizitorët e fundjavës, por edhe qendër kulturore e turistike (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Gjatë këtij mandati do të instalojmë pajisje monitorimi të ndotësve të ajrit në 12 qytetet kryesore në vend (E PAREALIZUAR).

Qeveria do të hartojë Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të zonave të mbrojtura (ZM), Parqeve Kombëtare (PK), Rezervateve Natyrore Strikt (RNS), për të mbrojtur ekosistemet e tyre, por edhe për t'i integruar ato në një plan afatgjatë me projektet infrastrukturore dhe turistike (E PAREALIZUAR).

Infrastruktura

Për ne është domosdoshmëri ndjekja e një qasjeje sektoriale për ujin nëpërmjet ndërtimit të një sistemi të integruar qeverisjeje dhe menaxhimi. Për jetësimin e kësaj qasjeje, mbështetur në parimet e gjithë përfshirjes dhe transparencës, do të hartohet dhe zbatohet një Program Kombëtar Sektorial afatgjatë (2018 – 2030).

Kjo do të realizohet përmes:

- shtrirjes së shërbimit të furnizimit me ujë, që do të arrijë në nivel kombëtar në masën 75 % (E PAREALIZUAR)¹⁵.
- shtrirjes së rrjeteve të kanalizimeve për largimin e ujërave të ndotur urbanë, që do të arrijë në nivel kombëtar në masën 48 % (E PAREALIZUAR).
- mbulimit të sipërfaqeve të tokave bujqësore me infrastrukturë ujitjeje e kullimi, që do të rritet me 40.000 ha për ujitjen dhe 70.000 ha për kullimin (E PAREALIZUAR)
- Plotësimi i nevojave të industrisë me ujë, me synim garantimin e ujit në sasinë dhe cilësinë e nevojshme do të jetë 100 % (E PAREALIZUAR).
- zvogëlimin e humbjeve në rrjet jo më shumë se 20% (E PAREALIZUAR).

Ndër projektet më prioritare të Qeverisë Shqiptare do të jenë:

- ✓ rrjeti qendror TEN-T Core (E PAREALIZUAR);
 - ✓ korridori Adriatiko – Jonian (E PAREALIZUAR);
 - ✓ akset Fushë-Krujë – Shkodër (zgjerim) (E PAREALIZUAR);
 - ✓ Thumanë-Kashar/Vorë (E PAREALIZUAR);
 - ✓ by-pass -et Tepelenë, Lezhë dhe Tiranë (PJESËRISHT E REALIZUAR);
 - ✓ ndërtimi dhe dublimi i aksit Milot – Rrëshen (E PAREALIZUAR);
 - ✓ përfundimi i by-pass-it të Fierit dhe atij të Vlorës (E REALIZUAR);
 - ✓ ndërtimi i Rrugës së Arbërit (PJESËRISHT E REALIZUAR).
- Përgatitja e një masterplan-i mbi investimet e mundshme duke ngritur një sistem të transportit të shpejtë hekurudhor për udhëtarë, për zonat turistike dhe me përqendrim

¹⁵ https://www.erru.al/doc/Raporti_vjetor_2020.pdf

të lartë urban (modeli i linjës së shpejtësisë së lartë Tiranë-Rinas-Durrës) (PJESËRISHT E REALIZUAR).

- Projekt mbi lidhjen e linjës mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, duke e futur rrjetin hekurudhor në kontekstin e një rrjeti rajonal të transportit hekurudhor, gjë e cila do të ndikonte në transformimin e Porteve të Durrësit, Shëngjinit dhe Vlorës si porte referencuese rajonale (E PAREALIZUAR).

Qeveria do të ketë përparësi zhvillimin e trekëndëshit tranzit Hani i Hotit –Durrës – Maqedoni e anasjelltas, gjë e cila do të rrisë ndjeshëm volumet e transportit me vendet fqinj (E PAREALIZUAR).

Objektivat kryesore të Qeverisë për vitet e ardhshme janë:

- ndërtim infastruktural aeroportual në jug të vendit (E PAREALIZUAR)
- përfshirja e shpejtë e Shqipërisë me të drejta të plota në Zonën e Përbashkët Europiane të Aviacionit, si dhe në Iniciativën Europiane “Qielli i Vetëm Europian” (Single European Sky), nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të përcaktuar në Marrëveshjen Shumëpalëshe të ZPAE-së (E PAREALIZUAR);

Edukimi, sporti, kultura

Brenda mandatit 2017-2021 do të përfundojnë punimet për rikonstrukcionin e plotë të Teatrit të Operës dhe Baletit, do të përfundojë qendra multi-funksionale e artit “Turbina” (E REALIZUAR),

Do të investohet në qendra kulturore multi-funksionale në qytete ku Rilindja Urbane ka rritur ndjeshëm interesin për kulturën (PJESËRISHT E REALIZUAR).

rikualifikim dhe rikonceptim të Muzeut Historik Kombëtar (PJESËRISHT E REALIZUAR);

rikonstruksion të Bibliotekës Kombëtare (PJESËRISHT E REALIZUAR);

rehabilitim të Galerisë Kombëtare të Arteve si një qendër e rëndësishme e historisë së artit shqiptar (E PAREALIZUAR).

Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës do të fillojmë gjithashtu ndërtimin për Teatrin e Ri Kombëtar (E PAREALIZUAR).

Ndërtimi i një Muzeu të Artit Bashkëkohor në akset e reja infrastrukturore që po i shtohen kryeqytetit (E PAREALIZUAR).

Edukimi masiv me art e kulturë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, duke ndërhyrë në kurrikulat e shkollës nga njëra anë dhe duke përfshirë në çdo institucion arti linjën pedagogjike dhe edukative nga ana tjetër, do të jetë prioritet në mandatin e dytë (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Prioritet do të marrë kombinimi i turizmit kulturor me agro-turizmin përmes programit të Rilindjes Rurale që do të synojë restaurimin e qendrave historike të fshatrave me potencial historik si QH Rehovë, QH Theth, QH Dhërmi, QH Vuno, QH Përmet (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Do të promovohen itinerare të reja turistike me karakter kulturor si “Rrugët e besimit”, korridoret e vjetra historike dhe tregtare, si “Via Egnatia”, duke kombinuar trashëgiminë kulturore, kulinarinë dhe artizanatin (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Reformat

Ne drejtësi

Reformë në sistemin e hartimit të legjislacionit dhe në tërësi sistemin e kodifikimit. Reforma tërësore e shërbimeve publike që lidhen me drejtësinë për titujt e pronësisë duke përfshirë rregjistrimin e tyre dhe kthimin dhe kompensimin e pronave (E PAREALIZUAR).

Reforma përfshin mënyrën e organizimit dhe strukturës të institucioneve përkatëse, futjen e teknologjisë dhe informatizimit të shërbimit, rekrutimit të stafit si dhe ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit, për ta bërë atë një shërbim cilësor, profesional dhe të shpejtë.

Reforma e shërbimeve publike të ofruara nga profesionet e lira, (noteria, avokatia, ndërmjetësimi) do të synojë shërbime ligjore, sa më cilësore dhe profesionale për qytetarët. Në këtë kuadër do të forcohen kushtet dhe kriteret profesionale për subjektet që e ofrojnë këtë shërbim publik, si dhe forcimi i mekanizmave kontrollues me qëllim shmangien e abuzimeve dhe veprimeve joligjore (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Reformim të thellë do të pësojë edhe sistemi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nëpërmjet shërbimit përmbartimor. Së pari, do të synojmë thjeshtimin dhe qartësimin e procedurave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Së dyti, do të rishikohet mënyra e funksionimit dhe organizimit të sistemit të shërbimit shtetëror dhe

atij privat të përmbarimit, duke përmirësuar mekanizmat kontrollues të këtij shërbimit të ofruar tek qytetarët (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Ne siguri dhe rend

Forcimi i institucioneve përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike. I gjithë efektiviteti i Policisë së Shtetit do t'i nënshtrohen procesit të *Vetting*-ut mbështetur në një kuadër ligjor të posaçëm të hartuar dhe monitoruar ngushtësisht dhe drejtpërdrejt nga partnerët ndërkombëtarë (E PAREALIZUAR).

Numri i punonjësve të policisë rrugore i pranishëm në akset rrugore gradualisht do të reduktohet dhe zëvendësohet nga pajisjet teknologjike (E PAREALIZUAR).

- Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, do të hartojmë Strategjinë Kombëtare të Inteligjencës dhe Informacionit, ku do të përfshihen ndër të tjera edhe Ngritja e një Sistemi Kombëtar të Unifikuar të Dhënash (Data Base). Do të ngrihet Shërbimi i Unifikuar i Komunikimit, i Menaxhimit të Fluksit të Dokumenteve të Punës, dhe Teknologjisë së Komunikimit dhe Informacionit si mjete menaxhimi efektiv brenda policisë së shtetit për administrimin e dokumenteve ligjore dhe për koordinimin efektiv me zyrën e Prokurorisë, Prokurorinë speciale dhe Byronë Kombëtare të Hetimit (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Ne edukim

Sigurimi i cilësisë së reformave dhe gjithëpërfshirja, nëpërmjet : rritjes së numrit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor dhe përfshirjes së klasës përgatitore në arsimin e detyrueshëm (E PAREALIZUAR).

Sigurimi i transportit të nxënësve në shkollat rurale (E PAREALIZUAR);

Deri në vitin 2021, çdo fëmijë rom dhe egjiptian, do të regjistrohet në shkollë, 100% e tyre do të mbarojnë arsimin e detyruar dhe 70% më shumë vajza e djem romë dhe egjiptianë do të përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit (E PAREALIZUAR).

Do të përmbyllem akreditimin ndërkombëtar për IAL-et (E PAREALIZUAR);
do të përmbyllem brenda vitit të parë të mandatit gjithë kuadrin institucional e rregullator për të vënë plotësisht në funksion mekanizmat e reformës;

do të realizojmë dhe standardizojmë Anketën Kombëtare Studentore, si instrument vlerësimi të çdo universiteti;

do të krijojmë platformën unike digjitale për të dhënat në arsimin e lartë (E REALIZUAR).

Shëndetësia

Financimi publik për kujdesin shëndetësor synohet të arrijë 60-65% të shpenzimeve totale të shqiptarëve për shëndetësinë (e gjetëm 43% në vitin 2013), duke siguruar që asnjë familje shqiptare të mos bjerë në varfëri për shkak të pagesës për kujdes shëndetësor (E PAREALIZUAR).

Qeveria do të vazhdojë politikat për uljen e çmimit të barnave, duke ruajtur cilësinë, duke rritur disponueshmërinë (E PAREALIZUAR).

Do të ngremë sistemin e gjurmimit (E PAREALIZUAR).

Do ta bëjmë shërbimin cilësor farmaceutik të disponueshëm në të gjithë territorin (E PAREALIZUAR).

Vëmendje të veçantë do të tregohet për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke mundësuar kujdes socio-shëndetësor në qendra të specializuara (E REALIZUAR).

Në vitin 2018 do të fillojë zbatimi i një programi 10-vjeçar për funksionimin e qendrave komunitare në të gjithë vendin për të koordinuar dhe ofruar shërbime në shëndetin mendor, kujdesin paliativ, shërbimet ndaj të rinjve, kontrollin e substancave abuzuese (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Deri në vitin 2021, koha e pritjes për të gjitha shërbimet spitalore do të përgjysmohet (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Qeveria do të inkurajojë procesin e akreditimit të të gjithë spitaleve publike dhe private (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Thirrjeve të rasteve urgjente do t'iu përgjigjemi brenda 10–15 minutave në zonat urbane dhe 20–35 minutave në zonat rurale (E REALIZUAR).

Brenda vitit 2020 me anë të PPP do të ndërtohet spitali rajonal i Fierit si qendër ekselence shërbimesh për qytetarët (E REALIZUAR).

Brenda vitit 2021 do të ndërtohen 8 qendra të reja shëndetësore (E REALIZUAR).

Politika sociale

Dhjetë marrëveshjet e nënshkruara gjatë mandatit qeverisës 2013-2017 në fushën e sigurimeve shoqërore do të pasohen me nënshkrimin e marrëveshjeve me vendet e tjera të BE-së gjatë katër viteve që vijojnë (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Emigrantët mund të përfitojnë pension bazuar në kontributet e paguara në Shqipëri dhe në vendin e emigrimit (E PAREALIZUAR).

Politikat tona do të mundësojnë uljen me 10% të punës së papaguar të grave, duke rritur aksesin në shërbimet sociale si çerdhe, kopshte, shërbime për moshën e tretë, shërbimet për gratë me aftësi të kufizuara, rome, egjiptiane, si dhe nënat me fëmijë me aftësi të kufizuara (E PAREALIZUAR).

Gjatë katër viteve të ardhshme do të rrisim punësimin dhe do të përgjysmojmë diferencën midis papunësisë rinore e papunësisë së përgjithshme, nëpërmjet mbështetjes së programeve “start-up”, shkollimit, formimit profesional dhe korsiive preferenciale në treg për punësimin e vajzave dhe djemve (E PAREALIZUAR).

Tri qendrave rinore të ngritura në Tiranë, Vlorë dhe Korçë do t’i shtohen edhe nëntë të tjera në Dibër, Kukës, Shkodër, Lezhë, Elbasan, Durrës, Berat, Fier dhe Gjirokastër (E PAREALIZUAR).

Programi i ndihmës ekonomike do të zëvendësohet nga programi “Mbështetje për riintegrim” (E PAREALIZUAR).

Gjatë mandatit tonë të parë, ne trefishuam ndihmën ekonomike nga 1.5 mijë në 4.5 mijë dhe nga 3 mijë në 8 mijë lekë. Deri në vitin 2021, një në dy familje përfituese të mbështetjes për riintegrim do të përfshihen në programin “Shqipëria punon”, duke mundësuar që deri në vitin 2025 në këtë program të përfshihen tri në katër familje (E PAREALIZUAR).

Gjatë mandatit tonë të dytë do të përfundojmë dëmshpërblimin e kësaj kategorie dhe do të mbështesim integrimin dhe pjesëmarrjen e tyre shoqërore, ekonomike e politike (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Mbrojtja, integrimi dhe siguria

Në periudhën kohore 2017-2021 Shqipëria do të synojë një rritje graduale dhe domethënëse të buxhetit të mbrojtjes, në përmbushje të angazhimit tonë përkundrejt




NATO-s në Uells dhe në Varshavë për t'i dedikuar 2% të PBB-së shpenzimeve të mbrojtjes deri në vitin 2024 (E PAREALIZUAR).

Brenda vitit 2019 do të krijohet njësi ushtarake e sigurisë kibernetike në bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë (PJESËRISHT E REALIZUAR).












Gjithashtu, brenda vitit 2019 do të realizojmë gatishmërinë operacionale të Grup-Batalionit të Këmbësisë së Mekanizuar, duke përbushur në këtë mënyrë detyrimet ndaj NATO-s në kapacitetet ushtarake (PJESËRISHT E REALIZUAR).

Do të krijohet një Agjenci Shtetërore e emigracionit dhe do të fillojë regjistrimi i tyre aty ku ata janë (E REALIZUAR).

QEVERISJA E PS – REALIZIMI PREMTIMEVE ELEKTORALE NË PROGRAMIN QEVERISËS 2017-2021

Përbushur	
Në progres	
Jo e përbushur	

PËRMBUSHJA E PROGRAMIT QEVERISËS TË PS

N r.	FISKALE/ BUXHETORE	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA / BURIMI
1	220,000 vende të reja pune		PO	INSTAT
2	Ekonomia do të rritet deri në 5.5 përqind		PO	KMF 2017-2021
3	Ulim tatimin mbi dividendin nga 15 në 6%		PO	L.T.A.
4	Norma maksimale e tatimit mbi të ardhurat personale do të zbesë nga 23% që është sot në 18%		PO	L.T.A.
5	2-fishim i investimeve të huaja direkte me 2 miliard euro		PO	
6	Përfitimi i lejes së lindjes për çdo nënë		PO	
7	Ulim borxhin publik nën 60 përqind të PBB-së		PO	PBA 2017-2021
8	Deficit buxhetor nën nivelin prej 2 përqind		PO	PBA 2017-2021
9	Financim i investimeve publike në rreth 5% e PBB-së		PO	PBA 2017-2021
10	Norma e papunësisë do të ulet nën nivelin dyshifror (8.2%)		PO	BSH
11	Fondi i pagave në sektorin publik rritet me 68 miliard lekë		PO	MFE ¹⁶
12	Lehtësim i barrës fiskale në 18% për të ardhurat nga pagat e larta		PO	L.T.A.

¹⁶ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Treguesit-analitik-fiskal-DHJETOR-2020-15.02.2021.pdf>

13	40% rritje e pagave, prioritet arsimit dhe shëndetësia		PO	BUXHETI 2021 ¹⁷
14	Paga minimale 30,000 lekë brenda mandatit		PO	L.T.A.
15	Paketa e solidaritetit për pensionistët 24 miliard lekë		PO	MFE, BUXHETI
16	PPP instrument financiar për projektet me rëndësi në ekonomi		PO	PBA 2017-2021
17	Rritje vjetore pensionesh dhe shpërblim fundviti nga 7-10 mijë lek		PO	KM ¹⁸
18	5% tatim fitimi për prodhimin në Teknologjinë e Informacionit		PO	L.T.A.
19	Ndihmë familjeve të reja për blerjen e shtëpisë së parë		PO	MONITOR ¹⁹
20	Transformojmë Ndihmën Ekonomike në Program për Riintegrimi social		PO	
21	Përfundojmë dëmshpërblimin e plotë të të përndjekurve politik		PO	P.B. 2021 ²⁰
22	Do të përfundojmë procesin e legalizimeve të ndërtimeve informale		PO	

N r.	SHËNDETËSIA	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA / BURIMI
1	Brenda 2021 shqiptarët do kenë shërbimet shëndetësore FALAS		PO	FSDKSH ²¹
2	Reagimi urgjencës 10-15 minuta në zonat urbane, 20-35 minuta në zonat rurale		PO	SH.K.U.M ²²
3	Financimi publik për kujdesin shëndetësor synohet të arrijë 60-65% e shpenzimeve totale/shëndetësi		PO	PBA 2017-2021

N r.	SOCIALE/ ADMINISTRATA	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA / BURIMI
1	Do të ulim me 10% punën e papaguar të grave		PO	N/A
2	40% gra në vendimmarrje në proceset publike, drejtuese dhe ligjvënësve		PO	N/A

¹⁷ <https://www.financa.gov.al/buxheti-2021/>

¹⁸ <https://kryeministria.al/newsroom/shperblimet-e-fundvitet-kategorite-qe-perfitojne/>

¹⁹ <https://www.monitor.al/shtepia-e-pare-per-ciftet-e-reja-qeveria-do-njohe-si-shpenzime-te-zbritshme-interesat-e-kredive/>

²⁰ <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/Relacioni-PB-2021-finale.doc>

²¹ <https://www.fsdksh.com.al/9-njoftime-t%C3%AB-ndryshme/464-sherbime-falas-edhe-ne-spitalet-jopublike>

²² <http://www.scan-tv.com/urgjencat-mjekesore-kerkohet-blerja-e-32-autoambulancave-te-reja-synon-te-ulet-koha-e-reagimit/>

3	Rritje e punësimit të rinjve përmes mbështetjes së “start-up”		PO	PBA 2017-2021
4	Banesa sociale në bashkëpunim me pushtetin vendor		PO	PBA 2017-2021
5	Rritje me 10% e numrit të përfituesve nga shërbimet komunitare		PO	U.N.D.P. ²³
6	Të gjitha shërbimet publike të aksesueshme nga kategoritë e aftësisë së veçantë		PO	L.P.A.P.A.K ²⁴ RAPORT ²⁵

N r.	ARSIMI	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA / BURIMI
1	Arsimi parashkollor i detyrueshëm në fund të mandatit		PO	INSTAT ²⁶ REPORTER ²⁷
2	Mësues ndihmës për çdo fëmijë me aftësi të veçanta		PO	
3	Mundësim i ushqimit në shkollë dhe rritje e kohëqëndrimit		PO	
4	225 shkolla në projektin “Shkolla Qendër komunitare”		PO	
5	Digjitalizim tërësisht i kurrikulave të arsimit parauniversitar		PO	
6	Ndërtojmë 140 shkolla të reja model për 40 mijë nxënës		PO	
7	Rritje deri në 40% e pagës së mësuesve		JO	BUXHETI 2017-2021
8	Arsim të lartë FALAS apo me bursat përkatëse për ekselentët		PO	TCH ²⁸
9	Garantim i punësimit në administratën publike të ekselentëve		PO	D.A.P. ²⁹
10	Akses falas studentëve në veprimtari publike, reduktim tarifash shërbime publike		PO	A.T.SH. ³⁰
11	Rritje e vazhdueshme e financimit publik për arsimin e lartë		PO	PBA 2019-2021 ³¹ PBA 2021-2023 ³²

²³ <https://www.al.undp.org/content/dam/albania/NewPublications/Raporti%20final%20dola.pdf>

²⁴ http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/ligj_nr_93_dt_24_7_2014.pdf

²⁵ <https://platforma-pak.al/wp-content/uploads/2019/06/Raport-Monitorimi-PKVPK.pdf>

²⁶ <http://www.instat.gov.al/media/5638/tab1.xlsx>

²⁷ <https://www.reporter.al/femijet-e-padukshem-mijera-nxenes-braktisin-shkollen-cdo-vit/>

²⁸ <https://top-channel.tv/2019/01/20/bursat-per-ekselentet-studentet-perfitojne-nga-janari-jo-nga-fillimi-i-vitit-akademik/>

²⁹ <http://dap.gov.al/dap/evente/396-platforma-punetembare-al-hapet-thirrja-per-vitin-2020-e-punesimit-te-ekselentëve>

³⁰ <https://ata.gov.al/2019/04/16/pakti-per-universitetin-40-sherbimet-qe-perfitojne-studentet-nga-karta/>

³¹ <https://financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2019-2021/>

³² <https://www.financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2021-2023-faza-ii/>

12	Çdo bashki me një shkollë profesionale për nevojat e tregut lokal	✗	PO	A.F.P. ³³
13	Transformim i 18 shkollave të mesme në shkolla ekselence sipas sistemit dual	✔	PO	
14	100% e fëmijëve romë e egjiptianë do kryejnë arsimin e detyruar	✗	PO	BUXHETI 2021 ³⁴

N r.	BUJQESI	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA / BURIMI
1	TVSH zero nga viti i parë i qeverisjes për plehrat kimike, farat, pesticidet dhe fidanët/ndihmesë prej 10 milion USD/vit	✔	PO	DPT ³⁵
2	Mbi 300.000 hektarë toka bujqësore me sistem ujitjeje dhe kullimi	✗	PO	
3	Përfundojmë shpërndarjen e certifikatave të pronës së tokës bujqësore	✗	PO	
4	232 milion USD më shumë financime për Bujqësinë	✗	PO	BUXHETI 2017-2021
5	71 milion EU mbështetje përmes programit të IPARD	✔	PO	MONITOR ³⁶
6	100 milion USD investime në rrugët dytësore me BB	✔	PO	PBA 2017-2021
7	95 milion EU kredi për agrobiznesin nga program me EBRD	✔	PO	EBRD ³⁷
8	23% rritje të financimit në programin e mbështetjes ndaj fermerëve	✔	PO	A.ZH.B.R. ³⁸ PBA 2017-2021

N r.	ENERGJI	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA / BURIMI
1	Përfundim i procesit të liberalizimit të tregut të energjisë për TL dhe TM	✗	PO	M.I.E. ³⁹ MONITOR ⁴⁰
2	Investime në burimet kryesore të gjenerimit, interkonjeksionit, dhe transmetimit	✔	PO	A.T.SH. ⁴¹ MONITOR ⁴²
3	Fillimi i ndërtimit të gazsjellësit Adriatiko-Jonian (IAP)	✗	PO	MONITOR ⁴³

³³ http://www.vet.al/ofruesit_arsimit_profesional/publike/teknike

³⁴ <http://financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/11-Ministria-e-Arsimit-Sportit-dhe-Rinise-2021-2023.xls>

³⁵ <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/932/perjashtimi-nga-tvsh-ja-e-inputeve-bujqesore-lehtesi-fiskale-per-fermeret>

³⁶ <https://www.monitor.al/shqiperia-merr-driten-jeshile-71-milione-euro-per-programin-ipard/>

³⁷ <https://www.ebrd.com/documents/comms-and-bis/psd-47735.pdf>

³⁸ <http://www.azhbr.gov.al/#>

³⁹ <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/ENERGJIA.pptx>

⁴⁰ <https://www.monitor.al/sfidat-e-sektorit-te-energji-se-ne-kohe-pandemie/>

⁴¹ <http://albanian.cri.cn/economy/more/3110/20210105/601114.html>

⁴² <https://www.monitor.al/sekretariati-i-energji-se-integrimi-i-tregut-mund-te-sjelle-800-milione-euro-investime-2/>

⁴³ <https://www.monitor.al/gjurma-shqiptare-e-korridorit-adriatiko-jonian-dhe-dritehijet-e-kostove-2/>

ALTAX

1444 DITË

TË QEVERISË "RAMA 2"

2017 - 2021

...në analizën tonë

POLIFAKT.al